



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 457/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me apelin e subjektit politik, koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.1659-2019 të datës 07.11.2019, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET i palejuar apeli Anr.457/2019 i datës 08.11.2019, i paraqitur nga subjekti politik, koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 07.11.2019, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 08.11.2019, ka pranuar një apel nga subjekti politik, koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, në të cilin subjekti politik në fjalë atakon rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të shpallur nga KQZ-ja me vendimin Nr.1659-2019 të datës 07.11.2019, me arsyetimin se me përfshirjen e 6.544 votave të votuesve jashtë Kosovës, të ardhura pas afatit ligjor, në rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të 6 Tetorit 2019, koalicioni NISMA-AKR-PD, është dëmtuar direkt në rezultatit zgjedhor, ashtu që ka kërkuar nga PZAP-i, që ta aprovojë apelin si të bazuar, t'i shpallë të pavlefshme këto 6.544 vota të ardhura nga diaspora dhe të obligojë KQZ-në, që të njëjtat t'i largojë nga rezultati përfundimtar i zgjedhjeve të 6 Tetorit 2019, i shpallur më datë 07.11.2019, pasi të njëjtat janë pranuar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi të cilat rregullojnë procesin zgjedhor.

PZAP-i, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së apelit gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli, pas shqyrtimit të apelit, gjeti se apeli i paraqitur nga subjekti politik, koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, është i njëjtë në aspektin përmbajtjesor me apelet e paraqitura nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, të evidentuara si Anr.375/2019 i datës 17.10.2019 dhe Anr.381/2019 i datës 07.11.2019, për të cilat Gjykata

Supreme e Kosovës ka vendosur me aktgjykimet A.A-U.ZH.nr.20/2019 të datës 30.10.2019 dhe A.A-U.ZH.nr.21/2019 të datës 05.11.2019. Prandaj nisur nga kjo gjendje faktike rezulton se çështja e ngritur me apelin e subjektit politik NISMA-AKR-PD, është çështje e vendosur me vendimet e lartpërmendura dhe vlerësohet si çështje e gjykuar.

PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e cekura më lart e në pajtim më dispozitat e nenit 11 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.457/2019 më datë 09.11.2019

Kryesues i Panelit

Rrustem Thaqi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.